

# Projektbuxheti 2024

Analizë e të hyrave dhe  
shpenzimeve buxhetore



## Projektbuxheti 2024

Analizë e të hyrave dhe  
shpenzimeve buxhetore

—  
Dhjetor 2023

## — Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive \_\_\_\_\_ 3

Projektbuxheti 2024 – pikat kryesore \_\_\_\_\_ 4

## Përmbledhje ekzekutive

Në hartimin e projektbuxhetit të vitit 2024, Qeveria është treguar më e matur në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve. Kjo për shkak që parashikohet një rritje e ngadalësuar e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, me 5% dhe 3% respektivisht, krahasuar me rritjen e parashikuar në projektbuxhetin<sup>1</sup> e vitit të kaluar (prej 22% dhe 17%). Nevoja për financim në vitin 2024 parashihet të jetë më e ulët se në vitin 2023 dhe deficitit buxhetor pritet të jetë brenda rregullës fiskale. Shpenzimet kapitale planifikohen të rriten më shumë sesa ato rrjedhëse, me 5% dhe 2% respektivisht, megjithatë, rritja e planifikuar është relativisht e ulët krahasuar me vitin paraprak, që ishte 15%. Tek shpenzimet rrjedhëse, për dallim nga viti i kaluar, kategoria e subvencioneve dhe transfereve ka pasur rënie, ku janë buxhetuar rreth 38 milionë më pak, ndonëse si kategori vazhdojnë të përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse (rreth 45%, e që është e ngjashme me vitin e kaluar që ishte 46%). Ndërsa kategoria e pagave dhe shtesave, këtë vit planifikohet të ketë rritje prej 59.9 milionë euro apo 8%, kryesisht për shkak të rritjes së vlerës monetare të koeficientit të pagave të sektorit publik nga 105 në 110 euro në vitin 2024. Me Projektbuxhetin 2024 është krijuar hapësirë edhe për 2,308 vende pune shtesë, nga të cilat 1,793 për nivelin qendror (kryesisht në Ministrinë e Punëve të Brendshme (Policia e Kosovës)) dhe atë të Mbrojtjes (FSK) dhe 515 për nivelin komunal.

Shpenzimet kapitale në vitin 2024 janë planifikuar të jenë 859.2 milionë euro, e që është rreth 4.5% më shumë se vitin e kaluar. Nga këto, rreth 83% janë vazhdim i projekteve të mëhershme, dhe 17% janë planifikuar për projekte të reja kapitale. Pjesëmarrja e buxhetit të ndarë për investime kapitale në Bruto Produktin Vendor ka një trend rënës nga viti 2017, dhe në vitet 2021 dhe 2022 ka mbetur e pandryshuar, në nivelin prej 8%. Përveç kësaj, buxheti i ndarë nuk arrin të realizohet tërësisht përgjatë vitit. Në vitin 2022, realizimi i kapitaleve ishte 60%, ndërkaq gjatë vitit 2023, deri në muajin shtator, shkalla e realizimit është 35%. Këtë vit, vlera e investimeve kapitale të reja të nivelit qendror të destinuar për projekte specifike në komuna është 21.8 milionë euro. Ngjashëm me vitin e kaluar, edhe këtë vit, qeveria ka ndarë më shumë mjete për komunat e udhëhequra nga Vetëvendosje (VV), ku mbi gjysma e kësaj shume (59.5% apo 13 milionë euro) janë orientuar në katër komunat e udhëhequra nga VV (Gjilan, Kamenicë, Podujevë dhe Shtime). Këto komuna përbëjnë vetëm 14.5% të sipërfaqes në Kosovë dhe 11.6% të popullsisë.

Në aspekt sektorial, shpenzimet në sektorin e shëndetësisë edhe pse do të kenë rritje për 42 milionë euro, si përqindje e Bruto Produktit Vendor (BPV) mbesin të ulëta krahasuar me shtetet e rajonit edhe ato të BE-së, rreth 4%. Shpenzimet e planifikuara për kategorinë e pensioneve dhe politikave sociale për vitin 2024 do të kenë rritje prej 15% nga viti i kaluar, dhe do të arrijnë vlerën prej 708.1 milionë euro (e që është rreth 8.5% e BPV-së). Rritje të buxhetit do të ketë edhe në sektorin e arsimit në vlerë prej 54.1 milionë euro apo 17% më shumë se vitin e kaluar, dhe në atë të drejtësisë në vlerë prej 102 milionë euro, e që është rreth 14.5 milionë euro më shumë se në vitin e kaluar.

Në aspekt të perspektivës gjinore, problem i vazhdueshëm i projektbuxhetit është mos-përfshirja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Përkundër faktit që nga viti 2017 organizatat buxhetore obligohen ligjërisht të bëjnë këtë përmes plotësimit të tabelave për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, të dhënat nga MFPT tregojnë se ende nuk ka ndodhur që këto tabela të plotësohen nga të gjitha komunat.

<sup>1</sup> Në këtë analizë, të gjitha krahasimet me vitin e kaluar bëhen me Projektbuxhetin e vitit 2023.

# Projektbuxheti 2024 – pikat kryesore


**Rritje e ngadalësuar e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore në vitin 2024.** Qeveria është treguar më konzervative në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për vitin 2024, krahasuar me vitin e kaluar. Më konkretisht, të hyrat buxhetore pritet të jenë rreth 3 miliardë euro, e që janë për 144 milionë euro (5%) më të larta krahasuar me projektbuxhetin e vitit të kaluar.

Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore në vitin 2024 parashihen të jenë rreth 3.3 miliardë euro, që shënon një rritje prej 3% apo rreth 91.3 milionë euro krahasuar me vitin 2023. Nga këto, pjesa më e madhe është për nivelin qendror, në vlerë prej 2.5 miliardë euro, ndërsa pjesa tjetër për nivelin lokal, rreth 742 milionë euro. Krahasuar me vitin paraprak, buxheti për nivelin qendror do të jetë për rreth 8.7 milionë euro më i lartë, apo 0.3%, ndërsa ai i nivelit lokal për 82.6 milionë euro më i lartë, apo 12.5%. Në vitin 2024 tri ministritë me buxhetin më të lartë janë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) me 931 milionë euro apo 180.1 milionë euro më pak krahasuar me vitin paraprak. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) me 265.4 milionë euro, apo 13.8 milionë më shumë krahasuar me vitin 2023 dhe Ministria e Punëve të Brendshme me 216.5 milionë euro apo 36.8 milionë euro më shumë se në vitin 2023. Të hyrat e buxhetuara parashihet të mbulojnë rreth 91% të shpenzimeve buxhetore, në vlerë prej rreth tre miliardë euro. Si rrjedhojë, nevoja për financim në vitin 2024 pritet të bie në 9% apo 285 milionë euro, nga 10% sa ishte në vitin 2023.

**Rritje e moderuar e shpenzimeve për paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime dhe rënie e lehtë e subvencioneve dhe transfereve.** Tek shpenzimet rrjedhëse, rritja më e madhe reflektohet tek kategoria e pagave dhe mëditjeve me rreth 59.9 milionë euro rritje buxhetore krahasuar me vitin paraprak. Një arsye kyçe e shumës më të lartë të buxhetuar për këtë kategori këtë vit është rritja e vlerës monetare të koeficientit të pagave të sektorit publik nga 105 në 110 euro. Me Projektbuxhetin 2024 është krijuar hapësirë edhe për 2,308 vende pune shtesë, nga të cilat 1,793 për nivelin qendror (kryesisht në Ministrinë e Punëve të Brendshme (Policia e Kosovës)) dhe atë të Mbrojtjes (FSK) dhe 515 për nivelin komunal. Krahasuar me projektbuxhetin e vitit 2023, në vitin 2024 shpenzimet për mallra dhe shërbime janë


**Figura 1.**

Struktura e financimit të buxhetit të Kosovës (në miliona euro)



**Figura 2.**

Rritja e shpenzimeve rrjedhëse, 2021–2024




rritur për 25.3 milionë euro (6%), investimet kapitale për 39.2 milionë euro (5%), shpenzimet komunale për 50 mijë euro (0.1%), dhe rezervat për 4.7 milionë euro (88%). Për dallim nga viti i kaluar, kategoria e subvencioneve dhe transfereve ka pasur rënie, ku janë buxhetuar rreth 38 milionë euro më pak. Megjithatë, subvencionet dhe transferet vazhdojnë të përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve rrjedhëse (rreth 45%, e që është e ngjashme me vitin e kaluar që ishte 46%). Për më shumë, kjo kategori e shpenzimeve përbën rreth 32% të gjithsej shpenzimeve buxhetore për këtë vit. Pjesa më e madhe e mjeteve në këtë kategori është ndarë për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, rreth 840 milionë euro. Nga këto, rreth 70 milionë euro për Pakon e Ringjalljes Ekonomike, 20 milionë euro janë ndarë si kontigjenca në MFPT, 7.5 milionë euro si kontigjenca për energji, dhe 4.2 milionë euro për zbatimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë çlirimtare të Kosovës.

**Rritje e ngadalësuar e shpenzimeve rrjedhëse dhe atyre kapitale.** Shpenzimet rrjedhëse për vitin 2024 janë planifikuar të jenë 2,396.8 milionë euro, e që janë për 47.3 (2%) më të larta se vitin e kaluar. Ndërsa, shpenzimet kapitale janë buxhetuar në vlerë prej 859.2 milionë euro, apo 39.2 (5%) milionë euro më shumë se vitin e kaluar. Ndonëse për të dy kategoritë parashihet rritje, kjo rritje konsiderohet relativisht e ulët, krahasuar me rritjen e planifikuar për vitin 2023. Për dallim nga viti i kaluar, rritja e shpenzimeve kapitale është më e lartë se ajo e atyre rrjedhëse.

**Figura 3.**

Rritja e shpenzimeve kapitale dhe rrjedhëse



## Shpenzimet Kapitale

**Rritje e financimit të investimeve kapitale nga buxheti i rregullt.** Gjatë këtij viti, mbi 91% apo 784 milionë euro e shpenzimeve kapitale do të mbulohej nga financimi i rregullt i buxhetit ndërsa 9% apo 75 milionë euro nga klauzola e investimeve. Krahasuar me vitin 2023, parashihet një rritje e financimit nga buxheti i rregullt prej 102 milionë euro apo 15%.


Ngjashëm me vitin e kaluar, as në vitin 2024 nuk pritet të përdoren fondet e likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), si burim financimi.

**Rreth 142.7 milionë euro investime kapitale të reja, apo 17% e gjithsej investimeve kapitale.** Për vitin 2024, janë buxhetuar gjithsej 859.2 milionë euro investime kapitale, nga të cilat 716.5 milionë euro apo 83% janë planifikuar për vazhdimin e projekteve të mëhershme dhe 142.7 milionë euro apo 17% janë planifikuar për projekte të reja kapitale. Krahasuar me vitin 2023, investimet kapitale të buxhetuara janë rritur për 48.2 milionë euro, megjithatë, përqindja e përqindja e pjesëmarrjes së investimeve të reja kapitale krahas atyre të vazhduara është zvogëluar nga 25% në 17%.

Nga këto 716.5 milionë euro për projektet e vazhduara, rreth 81% (apo 580.5 milionë euro) janë të alokuara tek niveli qendror dhe rreth 19% (apo 136 milionë euro) tek komunat.


**Figura 4.**

Financimi i shpenzimeve kapitale, në miliona euro



**Figura 5.**

Investimet e reja kapitale krahas atyre të vazhduara



### Investimet e reja kapitale të nivelit qendror nëpër komuna edhe këtë vit vazhdojnë të favorizojnë komunat e udhëhequra nga Vetëvendosje (VV).


Investimet e reja kapitale janë një indikator i qeverisë aktuale në shpërndarjen e investimeve, si dhe tregojnë orientimin e tyre, për dallim nga projektet e vazhduara kapitale që paraqesin buxhetimin nga qeveritë e kaluara. Historikisht, është vërejtur një tendencë e partive aktuale udhëheqëse të qeverisë të favorizojnë komunat që udhëhiqen nga po e njejta parti. Këtë vit, vlera e investimeve kapitale të reja të nivelit qendror të destinuar për projekte specifike në komuna është 21.8 milionë euro. Ngjashëm me vitin e kaluar, edhe këtë vit mbi gjysma e kësaj shume (59.5% apo 13 milionë euro) janë orientuar në katër komunat e udhëhequra nga VV (Gjilan, Kamenicë, Podujevë dhe Shtime). Këto komuna përbëjnë 14.5% të sipërfaqes në Kosovë dhe 11.6% të popullsisë.

Komuna me vlerën më të lartë të investimeve të reja edhe këtë vit vazhdon të jetë Gjilani, me investime në vlerë prej 6.3 milionë euro, apo rreth 29% të gjithsej investimeve të reja në komuna. Komuna e dytë me vlerën më të lartë është komuna e Shtimes, me investime të reja në vlerë prej 2.7 milionë euro, apo rreth 12.6% të gjithsej investimeve të reja. Komuna e tretë me vlerën më të lartë të investimeve është ajo e Prishtinës, me investime të reja në vlerë 2.3 milionë euro, që përbëjnë rreth 10% të gjithsej investimeve. Dy nga komunat e para udhëhiqen nga VV, ndërsa kjo e fundit udhëhiqet nga LDK.

Nëse analizohen këto investime për kokë banori, del se Komuna e Shtimes mban vlerën më të lartë, me 102.15 euro investime për kokë banori. Dy komuna të tjera me vlera të larta janë ajo e Gjilanit dhe e Kamenicës, me 85.69 dhe 80.26 euro investime për kokë banori, respektivisht.

**Figura 6.**

Investimet e reja kapitale nga niveli qendror në komuna në vitin 2024



Shënim: Shpërndarja e buxhetit në komuna sipas partive është bërë bazuar në partinë apo koalicionin fitues të zgjedhjeve në vitin 2021.

**Tabela 1.** Investimet e reja kapitale nga niveli qendror në komuna në vitin 2024

Komuna	Investimet e reja (€)	Investimet e reja (%)	Popullsia (%)	Sipërfaqja (%)	Subjekti Politik*	Investimet për kokë banori
<b>Gjilan</b>	6,300,000€	28.8%	0.0%	3.6%	VV	€85.69
<b>Shtime</b>	2,753,333€	12.6%	1.5%	1.2%	VV	€102.15
<b>Prishtinë</b>	2,300,000€	10.5%	12.3%	4.7%	LDK	€10.50
<b>Kamenicë</b>	2,100,000€	9.6%	1.5%	3.9%	VV	€80.26
<b>Podujevë</b>	1,855,000€	8.5%	4.5%	5.8%	VV	€23.04
<b>Mitrovicë</b>	1,150,000€	5.3%	3.8%	3.0%	PDK	€16.85
<b>Rahovec</b>	1,100,000€	5.0%	3.1%	2.6%	AAK	€19.86
<b>Pejë</b>	1,000,000€	4.6%	5.5%	5.5%	LDK	€19.07
<b>Prizren</b>	900,000€	4.1%	10.9%	5.50%	PDK	€4.64
<b>Lipjan</b>	400,000€	1.8%	3.2%	3.1%	LDK	€6.96
<b>Novobërdë</b>	400,000€	1.8%	0.4%	1.9%	LS	€56.58
<b>Deçan</b>	350,000€	1.6%	2.4%	2.7%	AAK	€8.24
<b>Vushtrri</b>	350,000€	1.6%	3.4%	3.2%	PDK	€5.74
<b>Obiliq</b>	333,500€	1.5%	1.0%	1.0%	IQ për Obiliqin	€19.32
<b>Viti</b>	200,000€	0.9%	2.7%	2.5%	LDK	€4.21
<b>Drenas</b>	185,000€	0.8%	3.4%	2.5%	PDK	€3.05
<b>Mamushë</b>	100,000 €	0.5%	0.3%	0.3%	KDTP	€17.21
<b>Suharekë</b>	100,000€	0.5%	3.2%	3.3%	AAK	€1.77

Çështja e shpërndarjes së pabarabartë të fondeve për investime kapitale nga ministritë në komuna gjithashtu është përmendur edhe në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën.<sup>2</sup>

## Realizim jo i lartë i investimeve kapitale dhe rënie në pjesëmarrjen në BPV

Shpenzimet kapitale paraqesin kategorinë kryesore të buxhetit shtetëror përmes të cilave mund të nxitet zhvillimi i mëtejshëm ekonomik, përmes krijimit të infrastrukturës së nevojshme dhe moderne në fusha të ndryshme. Problem ndër vite në rastin e Kosovës mbetet shpenzimi jo i lartë i buxhetit të kësaj kategorie. Konkretisht zvarritja dhe mos realizimi i projekteve, ku shumë nga to e tejkalojnë kohën e nevojitur për realizim dhe bartën nga viti në vit. Ka raste kur

<sup>2</sup> Komisioni Evropian. Kosovo 2023 Report. Bruksel, Nëntor 2023. Hapur së fundmi më 30 nëntor 2023.

Qeveria edhe ka huazuar mjete nga institucionet financiare ndërkombëtare, mirëpo të njëjtat i shfrytëzon në shkallë të vogël e të ngadalshme, ose nuk i disburson. Për këtë, është obliguar në disa raste të paguajë dhe tarifa për mos disbursim të kredisë (tarifë të zotimit).<sup>3</sup>


Viteve të fundit, vetëm rreth dy të tretat e buxhetit të planifikuar për investime kapitale arrin të realizohet. Ndërkaq buxheti i ndarë si përqindje e BPV-së del të jetë në rënie pas vitit 2017. Përveç kësaj, buxheti i ndarë nuk arrin të realizohet tërësisht përgjatë vitit. Në vitin 2022, kapitalet ishin realizuar vetëm në shkallën 60%, ndërkaq gjatë vitit 2023, deri në muajin shtator, shkalla e realizimit është 35%.

Tek investimet kapitale të realizuara në periudhën 2018–2022, vërehet një trend rënës i shpenzimeve për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtesave. Shpenzimet e bëra për ndërtimin e rrugëve në vitin 2022 ishin për 53% më të ulëta se në vitin 2019, ndërkaq ato për ndërtesa për 41% më të ulëta. Viteve të fundit vërehet një rritje më e ndjeshme e shpenzimeve për shpronësim.

Shpenzimet për shpronësim, që në vitin 2022 ishin për 124% më të larta se në vitin 2019, në një rën të anë mund të paralajmërojnë një dinamikë më të lartë investimeve kapitale në vitet në vijim, marrë parasysh që problemet e shpronësimeve mund të jenë arsye për bllokimin apo ngecjen e disa investimeve kapitale. Në anën tjetër, rritja e shpenzimeve të shpronësimit është një nga format më të lehta për të rritur performancën e kategorisë së investimeve kapitale, krahasuar me investimet që duhet të bëhen në rrugë, ndërtimin e objekteve të ndryshme, etj.


**Figura 7.**

Investimet kapitale të realizuara sipas llojit, 2018–2022



**Figura 8.**

Trendi i realizimit të investimeve kapitale në Kosovë dhe pjesëmarrja e kapitaleve në BPV, 2016 – tetor 2023




<sup>3</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti vjetor i auditimit 2022. Hapur së fundmi më 7 dhejtor 2023.



**Mbi 1700 projekte kapitale të vitit 2023 ende të pa filluara.** Ndër arsyet për këto zvarritje në kryerjen e investimeve publike mbeten planfikimi i dobët dhe kapacitetet zbatuese të dobëta.<sup>4</sup> Gjatë vitit 2023, në periudhën janar-shtator, janë 1740 projekte kapitale për të cilat nuk janë disbursuar fare mjete nga institucionet e nivelit qendror (ministritë dhe institucionet tjera) dhe të nivelit lokal. Niveli lokal prin me numrin e projekteve të pa filluara me 1101 sosh, kurse ministritë nuk kanë filluar 555 projekte kapitale.<sup>5</sup> Pra, nuk është kryer asnjë punë rreth këtyre projekteve gjatë kësaj periudhe. Tek ministritë, prin Ministria e Infrastrukturës me 167 projekte të pafilluara për të cilat buxheti i ndarë në vitin 2023 është rreth 43.7 milionë euro, pasuar nga Ministria e Kulturës me 165 projekte të pa filluara me vlerë prej 23.2 milionë euro. Gjithsej janë 555 projekte të pafilluara nga ministritë deri në shtator të vitit 2023, të cilat kapin vlerën rreth 165 milionë euro.<sup>6</sup>

### Figura 9.

Numri i projekteve kapitale të pa filluara, janar-shtator 2023, sipas ministrive



Ndërkaq, tek komunitat, prin ajo e Vushtrrisë me 138 projekte kapitale të pafilluara, që kapin vlerën prej 6 milionë eurove, pasuar nga Istogu me 92 projekte kapitale (3.1 milionë euro), Prizreni me 77 (7.4 milionë euro), Dragashi me 71 projekte (2.6 milionë euro), Prishtina me 70 projekte (29.3 milionë euro), etj. Në total janë 1101 projekte kapitale të pa filluara nga të gjitha komunitat së bashku në periudhën janar-shtator 2023.


<sup>4</sup> Komisioni Europian. Kosovo 2023 Report. Bruksel, Nëntor 2023. Hapur së fundmi më 30 nëntor 2023.

<sup>5</sup> Projektet tjera të pafilluara janë të institucioneve tjera, sikurse agjencive të pavarura etj.

<sup>6</sup> Këtu nuk janë përfshirë edhe 53.2 milionë euro të kontigjencave të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për kapitale.

Figura 10.

Numri i projekteve kapitale të pa filluara, janar-shtator 2023, sipas komunave




### Rritje e hendekut në mes të shpenzimeve kapitale dhe atyre për subvencione dhe transfere.

Derisa nën ekzekutimi i shpenzimeve kapitale ka qenë problem më i theksuar karshi shpenzimeve tjera për vite me rradhë në Kosovë, periudha e pas pandemisë ka filluar të shoqërohet me një nivel edhe më të ulët si dhe me një fokus të theksuar në subvencione dhe transfere. Përgjatë periudhës 2015–2024, vërehet një hendek në mes të këtyre dy llojeve të shpenzimeve.

Periudha e para pandemisë shoqërohej me shpenzime të ngjashme si në investime kapitale, ashtu dhe në subvencione dhe transfere. Për më shumë, hendeku i krijuar gjatë viteve 2020–2021 është i kuptueshëm për shkak të situatës me pandeminë. Mirëpo, edhe pas këtyre viteve nuk shihet një konvergjim i të dyjave drejt trendit të para pandemisë. Me Qeverinë aktuale të Kosovës, kemi një fokus më të madh në subvencione dhe transfere. Sidoqoftë, shifrat e viteve të fundit të ekzekutimit të shpenzimeve kapitale flasin edhe për nën ekzekutim. Derisa mesatarja e ekzekutimit të shpenzimeve kapitale para pandemisë, periudha 2015–2019, ishte rreth 77 përqind, kjo shifër gjatë vitit 2022 ka rënë në 60 përqind. Duhet cekur se përtej dallimeve ideologjike, teoria ekonomike (rreth multiplikatorit fiskal) është e qartë se kthimi ekonomik prej shpenzimeve kapitale është më i madh se ai në subvencione dhe transfere. Andaj, një ribalancim i këtyre dy shpenzimeve, sa më afër trendit të periudhës së para pandemisë, është i nevojshëm sidomos kur kemi parasysh gjetjet e fundit nga Banka Botërore se Kosovës i duhen edhe 30 vite në mënyrë që të hyrat për banor t'i afrohen shteteve evropiane të cilat Kosova aspiron për t'i arritur.<sup>7</sup>

**Figura 11.**

Shpenzimet kapitale vs subvencionet dhe transferet (realizim) si % e BPV




### Rreth 42 milionë euro më shumë për shëndetësi se në vitin 2023.

Buxheti i planifikuar në vitin 2024 për institucionet që mbulojnë fushën e shëndetësisë, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar, komunat, dhe Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, është gjithsej 337.8 milionë euro apo 41.6 milionë euro (14%) më shumë se në vitin 2023. Nga këto, buxheti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar është rritur për 34.7 milionë euro apo 25% krahasuar me vitin e kaluar. Nga gjithsej buxheti i SHSKUK, pjesa më e madhe përbëhet nga kategoria e pagave dhe shtesave (50%) përcjellur nga ajo e mallrave dhe shërbimeve (37%).

Gjithashtu, rritje kishte edhe granti për shëndetësi në komuna për 11.4 milionë euro apo 16%, dhe Fondi i Sigurimeve Shëndetësore për 61 mijë euro apo më pak se 1%. Në anën tjetër, buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë është ulur për 4.5 milionë euro apo 6%. Nga këto, pjesa më e madhe e buxhetit (40%) është e paraparë për investime kapitale, dhe një pjesë tjetër e madhe (37%) në mallra dhe shërbime.

**Figura 12.**

Buxheti për shëndetësi, 2021–2024




<sup>7</sup> Banka Botërore. Country Partnership Framework for the Republic of Kosovo. Prill, 2023. Hapur së fundmi më 30 nëntor 2023.

Krahasuar me shtetet e zhvilluara dhe ato rajonale, shpenzimet në sektorin e shëndetësisë në Kosovë mbesin të ulëta edhe në vitin 2024, përkatësisht 4% të Bruto Produktit Vendor. Bazuar në të dhënat e Eurostat, mesatarja e BE-së për shpenzimet publike në shëndetësi është 8.1%, në Republikën Çeke 9.8%, në Francë 9.2%, në Kroaci 8.6%, në Greqi 6.7%, në Rumania 5.5%, ndërsa në Zvicër vetëm 2.8%.<sup>8</sup>

Për më shumë, sipas raportit të Bankës Botërore për shpenzimet publike në Kosovë, edhe shpenzimet për shëndetësi për kokë banori janë në nivel të ulët. Më konkretisht, në vitin 2019 këto shpenzime ishin 226 dollarë për kokë banori, ndërsa në vendet e rajonit ishin: 275 euro në Shqipëri, 437 euro në Maqedoninë Veriore, 641 euro në Serbi e 735 euro në Mal të Zi. Rrjedhimisht, shpenzimet e ulëta në këtë sektor, sjellin pasoja sikurse buxhet të pamjaftueshëm për të paguar stafin mjekësor, për të bërë mirëmbajtjen e hapësirave dhe pajisjeve, ose për të bërë blerjen e nevojshme të pajisjeve mjekësore dhe medikamenteve, dhe si përfundim kualitet më të ulët të shërbimeve.<sup>9</sup>

Figura 13.


Shpenzimet në shëndetësi (% e BPV-së 2021)



**Rreth 95 milionë euro më shumë për pensione dhe politika sociale.** Shpenzimet e planifikuara për kategorinë e **pensioneve dhe politikave sociale** për vitin 2024 arrijnë vlerën prej 708.1 milionë euro, rreth 15% më e lartë se vitin e kaluar, dhe rreth 8.5% e BPV-së. Nga këto, pensionet dhe kompensimet parashihet të rriten për 55 milionë euro apo 15%, politikat dhe shërbimet sociale për 42.9 milionë euro apo 37%, ndërsa pensionet për kategoritë e luftës pritet të ulen për 3.4 milionë euro apo 3%, krahasuar me vitin e kaluar. Rënie parashihet të ketë edhe për Shërbimet e Administratës Qendrore me 2.1 milionë euro apo 16%, si dhe për Agjencinë e Inspektoratit të Punës për rreth 220 mijë euro apo 14%. Ndërsa, rritje do të ketë edhe për Agjencinë e Punësimit me 10 milionë euro, si dhe për Zbatimin e Ligjit Nr.04/L-054 me 1.1 milionë euro më shumë sesa vitin e kaluar.

Figura 14.

Buxheti i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)



<sup>8</sup> Eurostat. Shpenzimet e përgjithshme të qeverisë sipas funksionit. Luksemburg, Nëntor 2023. Hapur së fundmi më 20 nëntor 2023.

<sup>9</sup> Banka Botërore. Kosovo Public Expenditure Review 2023. Mars 2023. Hapur së fundmi më 20 nëntor 2023.

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Eurostat, ASK dhe MFPT

Edhe pse shpenzimet për kategorinë e pensioneve dhe politikave sociale janë në rritje edhe këtë vit, dhe përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit (rreth 21%), ende mungon targetimi specifik i përfituesve të këtyre pagesave. Në këtë mënyrë, ndonëse ka shumë përfitues të pagesave sociale, një numër i njerëzve në kategoritë më të varfra nuk përfitojnë sa duhet, marrë parasysh që disa nga pagesat nuk bazohen në të dhëna më specifike për ta si p.sh. të hyrat e tyre. Sipas Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023, targetimi i dobët i sistemit të asistencës sociale në Kosovë shkakton dekurajim të punësimit formal. Më konkretisht, çështja e pensioneve të veteranëve të luftës si dhe mungesa e përfitimeve sociale (sigurimeve shëndetësore) në punësimin formal, i dekurajon punëdhënësit dhe punonjësit të kalojnë në punësim formal. Për më shumë, ndarjet e mjeteve për asistencë sociale që synojnë varfërinë konsiderohen të ulëta (më pak se 0.5% e BPV-së).<sup>10</sup>

### Mbi 54 milionë euro më shumë për institucionet kryesore në sektorin e arsimit.


Në Projektbuxhetin e vitit 2024 parashihet një rritje prej 54.1 milionë euro apo 17% krahasuar me vitin 2023. Nga kjo rritje do të përfitojnë kryesisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me rreth 17.3 milionë euro buxhet shtesë dhe komunat përmes grantit për arsim me rreth 37.3 milionë euro shtesë. Rënie të buxhetit në këtë sektor pritet të ketë Universiteti i Prishtinës për 956 mijë euro, si dhe Akademia e Drejtësisë për 29 mijë euro.

Në fushën e arsimit, Kosova shpenzon rreth 4.5% të BPV-së, që është e përafërt me mesataren e BE-së prej rreth 4.8%.<sup>10</sup> Kjo përqindje është rreth 0.2% më e lartë se sa në projektbuxhetin e vitit 2023. Ndërsa, nëse krahasohen me gjithsej shpenzimet buxhetore përvitin 2024, shpenzimet për arsim nga institucionet më lart përbëjnë rreth 11.2% të tyre. Sipas raportit të Bankës Botërore për Kosovën, ndonëse shpenzimet buxhetore për arsim janë në nivel të ngjashëm me vendet e tjera, përfitimet e kapitalit njerëzor janë të limituara. Në nivelin lokal, dominojnë shpenzimet për paga, ndërsa shpenzimet kapitale dhe të mirëmbajtjes janë ende sfidë. Për më shumë, përmes prioritizimit të investimeve në objekte të edukimit të hershëm të fëmijëve, mundësohet rritja e qasjes në edukimin e hershëm të tyre, dhe rrjedhimisht rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.<sup>11</sup>

Tutje, sipas Komisionit Evropian, shpenzimet për fushën e arsimit për kokë banori janë ende të ulëta. Nisur nga kjo, Kosova duhet të rrisë fondet për studentë për kokë banori dhe nivelin e investimeve në arsimin cilësor.<sup>12</sup>


**Figura 15.**

Buxheti për arsim, 2023-2024



**Figura 16.**

Shpenzimet në arsim (% e BPV-së 2021)



<sup>10</sup> Eurostat. Shpenzimet e përgjithshme të qeverisë sipas funksionit. Luksemburg, Nëntor 2023. Hapur së fundmi më 20 nëntor 2023.

<sup>11</sup> Banka Botërore. Kosovo Public Expenditure Review 2023. Mars 2023. Hapur së fundmi më 20 nëntor 2023.


<sup>12</sup> Komisioni Evropian. Kosovo 2023 Report. Bruksel, Nëntor 2023. Hapur së fundmi më 30 nëntor 2023.

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Eurostat, ASK dhe MFPT

**Rreth 14.5 milionë euro më shumë për sektorin e drejtësisë.** Sipas projektbuxhetit 2024, buxheti për gjashtë institucionet qendrore, Prokurori i Shtetit/Këshilli Prokurorial i Kosovës (PSH/KPK), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Instituti Gjyqësor i Kosovës/Akademia e Drejtësisë (IGJK/AD), Ministria e Drejtësisë (MD), Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) dhe Agjensioni Kundër-Korrupsion (AKK) parashihet të jetë mbi 102 milionë euro. Krahasuar me vitin 2023, rritjen më të lartë të buxhetit do ta ketë Ministria e Drejtësisë me 11 milionë euro apo 31%, si dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës me 1.6 milionë euro apo 5%. Ngjashëm edhe buxheti për AKK-në do të jetë për rreth 408 mijë euro më i lartë, rritje kjo me 73% krahasuar me vitin 2023, për KPK-në buxheti do të jetë për 1.6 milionë euro më i lartë (8%), si dhe për ANJF rreth 94 mijë euro më i lartë apo 21%. Rënie të buxhetit pritet të ketë për Akademinë e Drejtësisë me 29 mijë euro apo 3%.

**Figura 17.**

Buxheti për disa institucione të sundimit të ligjit



Një çështje që është ngritur në Raportin e KE-së për Kosovën për sektorin e drejtësisë është rritja e buxhetit për Agjencinë Kundër Korrupsion, në mënyrë që të përmbushen përgjegjësitë dhe kompetencat e saj në mënyrë efektive. Për më tepër, rritja e buxhetit është thelbësore për të siguruar burimet e nevojshme për kryerjen e hetimeve të plota dhe zbatimin e masave efektive kundër korrupsionit.

**Neglizhimi i perspektivës gjinore në projektbuxhet.** Një tjetër problem i vazhdueshëm i projektbuxhetit është mos-përfshirja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Përkundër faktit që nga viti 2017 organizatat buxhetore obligohen ligjërisht të bëjnë këtë përmes plotësimit të tabelave për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, të dhënat nga MFPT tregojnë se ende nuk ka ndodhur që këto tabela të plotësohen nga të gjitha komunat. Një numër i madh i komunave nuk i kanë plotësuar të gjitha tabelat, disa i kanë dorëzuar me shumë gabime, nuk i kanë ndjekur udhëzimet, etj.


Edhe në projektbuxhetin 2024, nuk ka të dhëna lidhur me përfshirjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në procesin e hartimit të tij. Sipas një raporti të mëhershëm të Institutit GAP<sup>13</sup>, të dhënat lidhur me numrin e të punësuarve në sektorin publik komunal për vitin 2023 ofrohen nga 33 nga gjithsej 38 komuna (86.8%). Nga këto, del se gratë e punësuarat në këtë sektor përbëjnë 48.8% të gjithsej të punësuarve. Tutje, të dhënat lidhur me shpërndarjen e buxhetit të komunave sipas gjinisë, janë ofruar nga 34 nga gjithsej 38 komunat. Sipas këtyre të dhënave, në 22 komuna burrat marrin pjesën më të madhe të buxhetit të destinuar për paga, rreth 65%, ndërsa gratë dominojnë në këtë aspekt te 12 komunat e tjera. Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, gratë dominojnë numrin e përfituesve të subvencioneve në 12 komuna, ndërsa burrat në 11 komuna. Nëse përfitimet nga subvencionet analizohen sipas vlerës, del se burrat subvencionohen në vlera më të larta monentare sesa gratë (mesatarisht 695 euro me 609 euro respektivisht).<sup>14</sup>

Si përfundim, ende ka një neglizhim të perspektivës gjinore në projektbuxhet, ku në asnjë vit MFPT nuk ka arritur të grumbullojë të dhëna të plota nga të gjitha komunat.

<sup>13</sup> Instituti GAP. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor. Prishtinë, Maj 2023. Hapur më 20 nëntor 2023.

<sup>14</sup> Ibid.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.





Instituti GAP përkrahët nga:

